

dhjetor 2024

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin nëntor

2024

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin nëntor

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, dhjetor 2024

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

01.

Publikimet në gjuhën shqipe

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

Temat e përdorura për krijimin dhe

shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën

shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

02.

Publikimet në gjuhën serbe

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

Temat e përdorura për krijimin dhe

shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën

shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

03.

Kontrulli dhe vlerësimi i deklaratave

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë nëntorit 2024, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Formati i këtij raporti është i pari dhe i vetmi i llojit. Është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i 29-të mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma hibrid.info e specializuar në kontroll të fakteve, edukim digjital dhe medial, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në këtë raport monitorues jepet një pasqyrë për formën e përmbajtjeve me karakter informues për dhe rreth ngjarjeve në Kosovë. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të japë një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:

- Vlerësimet e artikujve keqinformues;
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese;
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues;
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues;
- Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave.


Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info, e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti, është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Klasifikimi i publikimeve në gjuhën shqipe dhe serbe (të tjera)

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës një mujore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në lidhje me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE

Publikimet në gjuhën serbe
7%



Publikimet në gjuhën shqipe
90%

Mostra e monitorimit dhe trajtimit të përmbajtjeve keqinformuese nga platforma “hibrid.info” fokusohet në keqinformimet në gjuhën shqipe, të publikuara në media, portale të dyshimta, si dhe faqe dhe llogari në mediat sociale. Si rezultat, gjatë muajit nëntor 2024, publikimet në këtë gjuhë përbënin 90% të rasteve të trajtuara.

Gjatë muajit nëntor, në kuadër të monitorimit, janë trajtuar 67 përmbajtje, ku 60 (90%) prej tyre ishin në gjuhën shqipe ndërsa 5 (7%) në gjuhën serbe dhe angleze 2 (3%), si dhe dy deklarata të paargumentuara.

1

Publikimet në gjuhën shqipe

Gjatë analizës së përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe për muajin nëntor 2024, është evidentuar se 90% e 67 përmbajtjeve të identifikuar janë në gjuhën shqipe.

Gjatë muajit nëntor 2024, analiza e 60 përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe ka zbuluar një përqindje të lartë të keqinformimit në kategori të ndryshme. Kategoria kryesore ka qenë "Lajm i rremë", që përbën 27% të rasteve, ndjekur nga "Dezinformatë" me 14% dhe "Clickbait" me 12%. Kategoritë e tjera, si "Mashtrim" (10%), "Dezinformatë/Clickbait" (8%), dhe "Përmbajtje e paverifikuar" (8%), gjithashtu kanë pasur një përfaqësim të rëndësishëm, ndërsa "Manipulim i fakteve" dhe "Gabim" përfaqësojnë nga 5%. Kombinimet e tjera të kategorive, si "Lajm i rremë/Mashtrim", kanë pasur përqindje më të ulëta.

Përmbajtjet keqinformuese janë përhapur kryesisht në disa fusha, me politikën që dominon me 37%, e ndjekur nga siguria me 25%. Kronika e zezë dhe temat sociale kanë përfaqësuar secila 10% të përmbajtjeve të pasakta. Në muajin nëntor, ka pasur një dallim të dukshëm në përqindjet e publikuesve të këtyre përmbajtjeve, ku media sociale dominon me 81%, duke treguar se platformat si Facebook dhe TikTok janë vendet kryesore për shpërndarjen e dezinformatave dhe lajmeve të rreme. Media tradicionale ka një përqindje më të ulët, me 15%, duke pasqyruar përhapjen më të vogël të informacionit të pasaktë nëpërmjet kanaleve tradicionale të lajmeve.

Përqindja e përmbajtjeve në gjuhën shqipe




Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

1.1

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Analiza e 60 përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe gjatë muajit nëntor 2024 ka zbuluar një përqindje domethënëse të rasteve të keqinformimit në kategori të ndryshme. Nga analiza e kryer, kategoria dominuese e keqinformimit ka qenë "Lajm i rremë", që përbën 27% të rasteve. Pas saj vijnë "Dezinformatë" me 14% dhe "Clickbait" me 12%. Kategori të tjera, si "Mashtrim" (10%) dhe kombinime si "Dezinformatë/Clickbait" (8%) dhe "Përmbajtje e paverifikuar" (8%), gjithashtu kanë një përfaqësim të rëndësishëm, ndërsa "Manipulim i fakteve" dhe "Gabim" përfaqësojnë nga 5% secila. Kategori të kombinuara si "Lajm i rremë/Mashtrim" dhe të tjera të ngjashme zënë përqindje më të ulëta.

Analiza e kategorive të keqinformimit për muajt tetor dhe nëntor tregon ndryshime të dukshme në formatet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve të keqinformuara. Lajmi i rremë ka mbetur kategoria dominuese në të dy muajt, me një rritje nga 24% në tetor në 27% në nëntor, duke konfirmuar se kjo formë vazhdon të jetë më e përhapura. Në të kundërt, mashtrimi ka pësuar një ulje të konsiderueshme, nga 16% në tetor në 10% në nëntor, duke treguar një rënie të kësaj forme të keqinformimit.

Dezinformatë, një tjetër kategori kryesore, ka shënuar një rritje nga 11% në tetor në 14% në nëntor, duke reflektuar një shtim të përmbajtjeve që manipulojnë faktet për qëllime të caktuara. Në përmbledhje, nëntori shënoi një rritje të dukshme të lajmeve të rreme dhe clickbait-it, duke treguar një tendencë drejt përdorimit të këtyre formateve për përhapjen e keqinformimit.



27% e artikujve keqinformues të trajtuar kanë marrë vlerësimin "lajm i rremë".

1.1.1.

Analizë e llojeve të vlerësimeve

01. Lajm i rremë

Lajmet e rreme janë publikuar kryesisht në media sociale, e cila përfaqëson 24% të rasteve, ndërsa vetëm 3% janë shpërndarë përmes mediave reale. Lajmet e rreme kanë prekur kryesisht fushën e politikës, e cila përfaqëson 14% të rasteve, ndërsa 7% kanë qenë të lidhura me çështjet e sigurisë. Tri temat që dominuan në përmbajtjet keqinformuese ishin Gjykata Speciale, zgjedhjet në Kosovë dhe armatosja e FSK-së, secila duke përfaqësuar nga 5% të rasteve. Këto tema reflektojnë interesin për çështje të ndjeshme politike dhe të sigurisë në diskursin publik.

03. Clickbait

Clickbait-i është publikuar në mënyrë të barabartë në media dhe media sociale, secila duke përfaqësuar 5% të rasteve. Keqinformata nga kronika e zezë që përbëjnë raste tragjike shpesh paraqiten me tituj që nuk e specifikojnë vendndodhjen e ngjarjes, duke krijuar paqartësi dhe shpërndarë informacion të pasaktë.

02. Dezinformatë

Dezinformatat janë publikuar kryesisht në media sociale, duke përfaqësuar 14% të rasteve totale. Brenda këtyre platformave, TikTok përbën 8% të përhapjes, ndërsa Facebook 5%. Dezinformatat janë shpërndarë në mënyrë të barabartë në fushat e sigurisë dhe politikës, secila duke përfaqësuar nga 7% të rasteve. Tema e armatosjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) ka përfaqësuar 5% të përmbajtjeve keqinformuese

04. Mashtrim

Përmbajtjet mashtruese janë publikuar kryesisht në media sociale (8%), dhe janë të lidhura me fushën sociale (8%). Tema dominuese që ka dalë nga këto përmbajtje mashtruese është subvencionimi për banim


Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë: + Dezinformatë / Clickbait, Përmbajtje e paverifikuara, Manipulim i fakteve, Gabim, Lajm i rremë / Mashtrim, Manipulim i fakteve / Dezinformatë, Përmbajtje e paverifikuara / Dezinformatë, Mashtrim / Dezinformatë

1.2

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

KATEGORITË KRYESORE


Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave



Në krahasimin midis tetorit dhe nëntorit bazuar në përqindjet e temave kryesore, vihet re një ndryshim në fokusin e keqinformatave. Nëse i bashkojmë zgjedhjet në Kosovë dhe sondazhet zgjedhore, këto tema së bashku përfaqësojnë 15% të përmbajtjeve keqinformuese. Ky grup temash ka pasur ndikim të madh në përhapjen e informacionit të pasaktë ndërlidhur me zgjedhjet (parafushatën zgjedhore) dhe besueshmërisë së sondazheve. Përmbajtjet keqinformuese kanë pasur fokus kryesor në disa tema, duke përfshirë zgjedhjet në Kosovë dhe armatimin e FSK-së, secila duke përfaqësuar 10% të rasteve. Pas këtyre, ka pasur një përqindje të konsiderueshme të keqinformimit rreth Gjykatës Speciale (8%). Po ashtu, temat si sulmi në kanal in “Ibër-Lepenc”, sondazhet zgjedhore dhe zgjedhjet në SHBA, secila me 5%, kanë kontribuar në shpërndarjen e informacionit të pasaktë.

Nëse e krahasojmë me muajin tetor, përmbajtjet keqinformuese që lidhen me sondazhet zgjedhore dhe zgjedhjet në Kosovë janë përhapur më shumë në muajin nëntor, duke arritur një total prej 15% (krahasuar me 13% për sondazhet zgjedhore dhe 5% për zgjedhjet në Kosovë në tetor).

Disa pretendime të rreme të publikuara në media sociale për lirin e Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit kanë bërë që tema e lidhur me Gjykatën Speciale të jetë një nga temat dominuese në muajin nëntor. Një shpërthim që ka ndodhur mbrëmjen e 29 nëntorit në fshatin Varragë të komunës së Zubin Potokut, i cili ka dëmtuar kanal in e ujit “Ibër-Lepenc”, ka nxitur publikimin e disa keqinformatave lidhur me këtë ngjarje.



33% e temave kryesore janë për zgjedhjet (sondazhe) zgjedhore, armatimia e FSK-së dhe Gjykata Speciale.

Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

1.2.1.

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hibrid.info, përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Zgjedhje në Kosovë

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese janë publikuar kryesisht në media sociale dhe lidhen me temën e zgjedhjeve në Kosovë, duke përfshirë një përqindje të konsiderueshme të shpërndarë në fushën e politikës. Pretendime të rreme dhe keqinformuese janë shpërndarë në mediat sociale, përfshirë deklaratën e vjetër të Armend Mujës për dominimin e PDK-së në fushatë, pretendimin se Sami Lushtaku do të jetë kandidat për president dhe një postim në Facebook që e ndërlidhë gabimisht emrin e Faton Pecit. Po ashtu, është shpërndarë një foto e Albin Kurtit dhe Jeff Hovenier me pretendimin e pasaktë se një gjeneral amerikan e ka lavdëruar Kurtin për ballafaqimin me ndikimin rus, si dhe një pretendim se Ramush Haradinaj ka propozuar një marrëveshje me LDK, PDK dhe Lista Srpska.

02. Armatosja e FSK-së

OTë gjitha përmbajtjet lidhur me armatimin e FSK-së janë publikuar në media sociale, kryesisht nga fusha e sigurisë, dhe ato përfshijnë dezinformata dhe lajme të rreme. Në media sociale janë shpërndarë pretendime të rreme se Kosova ka arritur marrëveshje me Turqinë për sistem raketor, se SHBA-të do të ndihmojnë FSK-në me dronë dhe automjete ushtarake, dhe se Kosova ka marrë pajisjet ushtarake KORKUT 8x8 dhe ACV-15 nga Turqia. Po ashtu, është pretenduar se SHBA-të do të dërgojnë 250 automjete ushtarake për Ushtrinë e Kosovës.

03. Gjykata Speciale

Për Gjykatën Speciale, janë publikuar lajme të rreme dhe mashtrime në media sociale, të cilat kanë qenë të lidhura me fushën e drejtësisë. Ka pasur shpërndarje të pretendimeve të rreme lidhur me lirimimin e Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit nga Gjykata Speciale. Në disa postime në TikTok dhe Facebook, është pretenduar se ata do të lirohen më 20 dhjetor dhe se Edi Rama, kryeministri i Shqipërisë, ka shprehur gëzim për këtë ngjarje. Për më tepër, ka pasur spekulime se më 20 dhjetor do të organizohet një pritje festive për ta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.

03. Sulmi në kanalin “Ibër-Lepenc”


Lidhur me temën e sulmit në kanalin “Ibër-Lepenc”, janë publikuar përmbajtje në media sociale, të cilat janë vlerësuar si clickbait, gabim, dhe përmbajtje e paverifikuar/dezinformatë. Në disa video-materiale është pretenduar se ambasadori britanik ka kërcënuar dhe identifikuar autorët e sulmit ndaj kanalit të ujit në veri, se kryeministri Rama ka vlerësuar se akti u krye nga serbët, se një gazetar ka deklaruar se qytetarët në atë pjesë kanë mbetur pa energji elektrike dhe se shpërthimi ka ndodhur në digë. Megjithatë, pas verifikimit të fakteve, është konfirmuar se shpërthimi i së premtes në Zubin Potok ka ndodhur në kanalin e ujit “Ibër-Lepencit dhe jo në ndonjë digë, siç është pretenduar. Po ashtu, një video e publikuar më 29 nëntor pretendon se shumë vende në Kosovë kanë mbetur pa energji elektrike si shkak i shpërthimit në Zubin Potok.

1.3

Llojet e fushave

Si rezultat i gjetjeve lidhur me përmbajtjet keqinformuese të trajtuara gjatë muajit nëntor, rezulton se publikues të ndryshëm (media reale dhe mediat sociale) kanë prodhuar dhe shpërndarë kryesisht përmbajtje keqinformuese në fushën e politikës, e cila përbën 37% të totalit.

FUSHAT KRYESORE
Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore



Përmbajtjet keqinformuese janë përhapur kryesisht në disa fusha të ndryshme. Tema më dominuese është politika, me 37%, ndjekur nga siguria me 25%. Përqindja e përmbajtjeve keqinformuese në fushat e kronikës së zezë dhe sociale është 10% secila. Po ashtu, drejtësia përbën 8%, ndërsa sporti është më i ulët me 3%. Fusha të tjera, si arsimi, turizmi, dhe katastrofat natyrore, përbëjnë 2% të përmbajtjeve të keqinformuara.

Në krahasim me muajin tetor, ka pasur disa ndryshime në shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese. Në tetor, politika dominonte me 44%, e pasuar nga socialja me 24%, dhe siguria me 15%. Ndërsa për muajin nëntor, politika ka pësuar një ulje të vogël në 37%, kurse siguria ka rritur përqindjen në 25%. Kronika e zezë dhe socialja kanë mbetur të qëndrueshme në 10% për secilën. Shëndetësia, që ishte e pranishme vetëm në tetor me 4%, nuk është përmendur në nëntor, ndërsa përqindja e sportit është rritur nga 2% në tetor në 3% për nëntorin.



82% e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara janë nga fusha e politikës, sigurisë, kronikës së zezë dhe sociale.

Llojet e publikuesve


1.4

Duke u bazuar në analizat e përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe, rezulton se keqinformatat nga faqet dhe llogaritë në mediat sociale vazhdojnë të jenë të pranishme në mënyrë të theksuar edhe gjatë muajit nëntor.

Në muajin nëntor, dallimi në përqindje për publikuesit e përmbajtjeve keqinformuese është i dukshëm. Media sociale dominon me 81%, që tregon se platformat si Facebook, TikTok janë vendet kryesore për shpërndarjen e dezinformatave dhe lajmeve të rreme. Media ka një përqindje më të ulët, me 15%, duke u reflektuar kështu në përhapjen e informacioneve të pasakta nëpërmjet kanaleve tradicionale të lajmeve. Ndërsa SMS-të dhe portalet e dyshimta përbëjnë 2% secila, duke treguar se këto janë burime më të kufizuara të shpërndarjes së përmbajtjeve keqinformuese.

Në krahasim me muajin tetor, vërehet një rritje e përdorimit të mediave sociale, që kanë arritur 81% në muajin nëntor, krahasuar me 73% që ishte në tetor. Ky ndryshim tregon një rritje të përdorimit të platformave të tilla si Facebook dhe TikTok për shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese. Media ka një ulje të përqindjes nga 18% në 15%, duke reflektuar një rënie të roleve të mediave tradicionale në shpërndarjen e dezinformatave. Media të dyshimta kanë mbetur në nivele të ngjashme, me 2% në të dy muajt.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE



81% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga publikuesit në media sociale

Llojet e mediave sociale


1.5

Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë nga publikuesit në media sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Në muajin nëntor, TikTok ka pasur dominimin më të madh në shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese, me një përqindje prej 57%. Pas tij, Facebook ka kontribuar me 37% të përmbajtjeve të keqinformuese. YouTube dhe WhatsApp janë më pak të prekur, me 4% dhe 2% përkatësisht. Ky trend tregon se platforma të tilla vizuale dhe të shpejta si TikTok kanë një ndikim të madh në përhapjen e keqinformacionit.

Në krahasim me muajin tetor, nëntori ka treguar një rritje të konsiderueshme të përmbajtjeve keqinformuese në TikTok, nga 38% në 57%, duke u bërë platforma më e prekur. Facebook gjithashtu ka shfaqur një rritje, nga 24% në 37%. Ndërkohë, YouTube, Telegram, dhe WhatsApp kanë parë rënie, nga 7% dhe 2% në tetor, duke reflektuar një ndryshim të mundshëm në mënyrën se si shpërndahen këto përmbajtje në muajin nëntor.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË
MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

1.6

Kjo matje, përmes të dhënave monitoruese, analizon ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, llogarive, mediave dhe kanaleve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Në mediat sociale, përmbajtjet keqinformuese janë shpërndarë nga lloje të ndryshme publikuesish.

Në platformën Facebook, përmbajtjet keqinformuese janë shpërndarë kryesisht nga faqet (29%) dhe në një masë më të vogël nga media (8%). Në platformën TikTok, përmbajtjet keqinformuese janë shpërndarë kryesisht nga faqet (55%), ndërsa mediat kanë kontribuar në një masë shumë më të vogël (2%). Në YouTube, përmbajtjet keqinformuese janë publikuar kryesisht nga media, duke zënë 4% të rasteve totale të identifikuara. Në WhatsApp, përmbajtjet keqinformuese janë shpërndarë përmes numrit të telefonit, duke përbërë 2% të publikimeve totale.



1.6.1.

Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

01. TikTok

01.Në TikTok, përmbajtjet keqinformuese janë fokusuar kryesisht në temat e politikës (24%), të ndjekura nga çështjet e sigurisë (16%) dhe drejtësisë (10%), duke reflektuar interesin e lartë për tema të ndjeshme dhe aktuale. Dy kategoritë dominuese të përmbajtjeve keqinformuese në TikTok gjatë muajit nëntor ishin lajmet e rreme (27%) dhe dezinformatat (10%), duke përbërë pjesën më të madhe të keqinformimeve të shpërndara. Temat kryesore për të cilat u keqinformua në TikTok gjatë muajit nëntor përfshijnë pretendime të rreme për armatosjen e FSK-së (12%) me pajisje ushtarake; keqinformata ndërlidhur me zgjedhjet në Kosovë (10%), pretendime të rreme se Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli do të lirohen me 20 dhjetor nga Gjykata Speciale (10%); si dhe sondazhe të rreme, të manipulara zgjedhore (6%), duke reflektuar një fokus të madh në çështje politike dhe të sigurisë.

02. Facebook


Në Facebook, përmbajtjet keqinformuese kanë qenë kryesisht nga fusha e politikës (16%) dhe sigurisë (8%), ku kanë dominuar “Përmbajtje e pa verifikuar” me 10% dhe “Dezinformata” me 6%. Temat kryesore të keqinformimit në Facebook përfshijnë: “Subvencion i banimit” me 4%, “Sulmi në kanal in Ibër-Lepenc” me 4%, dhe “Zgjedhjet në SHBA” me 4%. Dy temat kryesore të keqinformimit lidhen me shpërthimin në Zubin Potok; Është pretenduar në mënyrë të pavërtetë se shpërthimi ka ndodhur në një digë dhe se shumë zona të Kosovës mbetën pa energji elektrike si pasojë e tij.

Figurat dhe institucionet më të përfolura

1.7.

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.

RENDITJA E INSTITUCIONEVE MË TË PËRFOLURA SIPAS PËRQINDJES




Sipas analizës së 59 përmbajtjeve keqinformuese të identifikuara dhe trajtuara gjatë muajit nëntor 2024, ka rezultuar se 21 prej këtyre përmbajtjeve përmendin institucione të ndryshme. FSK dhe Partitë Politike (LVV, LDK, PDK, AAK) janë dy institucionet më të përfolura gjatë muajit nëntor në gjuhën shqipe.

FSK-ja është përfolur në lajme të rreme dhe dezinformata të publikuara në TikTok, kryesisht lidhur me armatosjen e këtij institucioni të sigurisë me pajisje të ndryshme ushtarake.

Partitë politike janë përfolur në lajme të rreme dhe mashtrime të publikuara në TikTok dhe Facebook, duke përfshirë pretendime të ndryshme si: një sondazh i supozuar nga kompania amerikane SDGs Global Survey; për përkrahjen qytetare të subjekteve politike; një mbishkrim që thotë se Ramush Haradinaj ka propozuar ndarjen e qeverisjes mes LDK-së, PDK-së dhe Listës Serbe; postime me përqindje dhe figura të kandidatëve për kryeministër të Kosovës; dhe përmbajtje që pretendojnë se partitë opozitare janë kundër rritjes së pagave dhe planifikojnë ta dërgojnë vendimin në Gjykatën Kushtetuese.

Gjatë muajit nëntor, përveç dy institucioneve kryesore, janë përfolur edhe institucione të tjera në përmbajtje keqinformuese, përfshirë Qeverinë (5%), Policinë e Kosovës (5%), partitë politike si AAK dhe LDK (5%), Aeroportin e Prishtinës (5%), PDK-në (5%), si dhe kompanitë e telekomunikacionit Ipko dhe Vala (5%).

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Gjatë muajit nëntor, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka qenë figura më e përmendur në përmbajtjet keqinformuese në gjuhën shqipe, shpeshherë në kontekst krahasues me figura të tjera politike.

Si i vetëm, Kurti u përmend në një video të publikuar në TikTok. Por videoja është e vjetër dhe paraqitet rrejshëm si ngjarje aktuale; Albin Kurti, Bedri Hamza, Lumir Abdixhiku dhe Ramush Haradinaj u përfolën në dy keqinformata të publikuara në TikTok, të lidhura me sondazhe zgjedhore; Kurti u përfol me Donald Trump në media sociale, me pretendimin se ai ka thënë se e kap ankthi vetëm kur e mendon fitoren e Trump. Po ashtu është përfolur me gjeneralin amerikan, Eric Friedman, ku u pretendua rrejshëm në TikTok se Friedman ka thënë se Kosovës i duhen njerëz si Albin Kurti për t'i bërë ballë ndikimit rus. Kurti u përfol në mediat sociale me ambasadorin amerikan Jeffrey Hovenier, ku pretendimi i rremë ishte se një raport amerikan thoshte se Kurti do të fitonte 70% të votave dhe do t'ia bashkonte Kosovën Shqipërisë. Kurti u përfol në një keqinformata në TikTok me gazetarin Halil Matoshi, ku pretendimi ishte se Matoshi kishte thënë “Albin Kurti është njeri i UDB-së”. Kurti u përfol në një pretendim në media sociale, ku thuhet se presidenti i SHBA-së, Joe Biden, ka deklaruar se momenti më i keq në raport me Kosovën ishte kur grupe të organizuara nga ai Kurti sulmuan ambasadorin amerikan të asaj kohe, Tracey Ann Jacobson.

Të gjitha personalitetet e tjera janë përfolur nga një herë në keqinformatat e publikuara gjatë muajit nëntor.

2.

Publikimet në gjuhën serbe

Nga analiza e 67 përmbajtjeve keqinformuese, 5 prej tyre (7%) rezultuan të publikuara në gjuhën serbe. Përmbajtjet keqinformuese janë publikuar kryesisht në media, duke përfshirë edhe një pjesë në media sociale (Telegram). Përmbajtjet keqinformuese i përkasin kryesisht fushave të politikës dhe sigurisë, me shumicën e tyre të fokusuar te politika. Përmbajtjet keqinformuese përfshijnë manipulime të fakteve dhe dezinformata, teori konspirative dhe lajme të rreme.

Temat kryesore: Përmbajtjet keqinformuese trajtojnë tema të ndryshme, duke përfshirë zgjedhjet në SHBA, nënstacionet policore në veri të Kosovës, raportet mes Kosovës dhe NATO-s, si dhe krahasimin ndërmjet luftës së Kosovës dhe agresionit rus në Ukrainë.

Kategoritë e vlerësimit për përmbajtjet keqinformuese përfshijnë manipulime të fakteve dhe dezinformata, teori konspirative, lajme të rreme, dhe përsëritje të manipulimit të fakteve dhe dezinformatave.

Pretendimet keqinformuese janë përhapur kryesisht në fushat e politikës dhe sigurisë, me dy përfaqësime të këtyre fushave në përmbajtjet e trajtuara.

Personat e përfolur në përmbajtjet keqinformuese janë Kamala Harris, Albin Kurti, Petar Petković dhe Sergey Lavrov.

Një video e publikuar në "Telegram" tregon muralin e Kamala Harris duke u fshirë, me pretendimin se ndodhet në Prishtinë. Megjithatë, informacioni është i pasaktë, pasi murali i Kamala Harrisit nuk ndodhet në Prishtinë, por në Atlanta të SHBA-së. Ky është një manipulim i fakteve dhe dezinformata që përhapet në media sociale.

Petar Petković ka lidhur pa asnjë fakt ndërtimin e nënstacionit të ri policor në Zveçan me "pushtimin e veriut të Kosovës", duke e cilësuar këtë si një vazhdimësi të "militarizimit ilegal dhe të dhunshëm". Ky është një pretendim që përbën një teori konspirative, i përhapur në media sociale dhe të shkruara në gjuhën serbe. Personat e përfolur në këtë kontekst janë Albin Kurti dhe Petar Petković.

Një lajm i rremë ka qarkulluar për pjesëmarrjen e Kosovës në Asambleen e Përgjithshme të NATO-s, ku është pretenduar se delegacioni i Kosovës ka marrë pjesë në punimet e saj në Montreal, Kanada. Ky informacion i pasaktë është transmetuar nga media në gjuhën serbe dhe është shpërndarë në media në gjuhën shqipe, duke krijuar konfuzion rreth marrëdhënieve të Kosovës me NATO-n.

Sergey Lavrov, ministri i Punëve të Jashtme të Rusisë, ka përsëritur një pretendim dezinformues, duke krahasuar masakrën në Bucha të Ukrainës me ngjarjet e Reçakut në Kosovë në janar të vitit 1999. Ky është një manipulim i fakteve dhe dezinformatë, i shpërndarë në media dhe i përdorur për të krijuar paralelizma të pasakta mes dy ngjarjeve tragjike.

Murali i Kamala Harrisit s'është në Prishtinë, por në Atlanta të SHBA-së	Manipulim i fakteve/Dezinformatë	Zgjedhjet në SHBA	Telegram	“Në Prishtinë u ngutën para se ta shihte Trumpi”, mban mbishkrimin një video e publikuar në “Telegram”, i përcjellë me një emotikon duke qeshur me lot.
Lajm i rremë për pjesëmarrjen e Kosovës në AP të NATO-s	Lajm i rremë	Kosova dhe NATO	Media	Media në gjuhën shqipe ka transmetuar informacionin e pa saktë të medias në gjuhën serbe duke pretenduar se delegacioni i Kosovës ka marrë pjesë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të NATO-s në Montreal, Kanada.
Petkoviqi ndërlihd pa fakte ndërtimin e nënstacionit të ri policor në Zveçan me pushtim të veriut	Teori konspirative	Nënstacionet policore në veri	Media	Është pretenduar se ndërtimi i një nënstacioni të ri policor në komunën e Zveçanit, është “vazhdimësi e militarizimit ilegal dhe të dhunshëm si dhe i pushtimit të veriut të Kosovës”.
Lavrov përsërit pretendimin dezinformues se masakrat në Bucha dhe Reçak janë të inskenuara	+ Manipulim i fakteve / Dezinformatë	Krahasimi Kosovë-Ukrainë	Media	Ministri i Punëve të Jashtme të Rusisë, Sergey Lavrov, ka përsëritur pretendimin e të njohur dezinformues duke e krahasuar masakrën në Bucha të Ukrainës, me ngjarjet e ndodhura në fshatin Reçak në Kosovë në janar të vitit 1999.

3.

Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave

Hibrid.info, përveç kontrollit dhe analizës së artikujve mediatik, bën edhe kontrollin dhe vlerësimin e deklaratave të zyrtarëve të lartë politikë e institucionalë, si dhe figurave që kanë ndikim publik. Vlerësimi i këtyre figurave, sipas metodologjisë së hibrid.info, bëhet në kategoritë e vërtetësisë, qëndrueshmërisë dhe përmbajtjes së premtimeve.

RENDITJA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT TË DEKLARATAVE

Deklaratë e paargumentuar/Përmbajtje e...	Deklaratë e paargumentuar
<p>Politika</p> <p>Deklarata për gruan e Kurtit</p> <p>Branislav Kërstiq</p>	<p>Siguria</p> <p>Sulmi në kanalin Ibër-Lepenc</p> <p>Petar Petkoviç</p>

Në kuadër të përmbajtjes së monitoruar gjatë muajit nëntor, hibrid.info ka kontrolluar dhe analizuar 2 deklarata.

Gazetari dhe opinionisti Branislav Kërstiq ka bërë një deklaratë të paargumentuar, duke pretenduar se bashkëshortja e kryeministrit Albin Kurti, Rita Augestad Knudsen, jeton dhe punon në Beograd, pa ofruar asnjë provë për këtë pohim. Për më tepër, mediat vendore kanë transmetuar këtë deklaratë pa e verifikuar vërtetësinë e saj.

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviç, e ka cilësuar shpërthimin në kanalin “Ibër-Lepenc” si një alibi për autoritetet e Kosovës për të vazhduar “persekutimin e serbëve” në veri, por nuk ka ofruar prova për këtë pretendim. Platforma Hibrid.info ka trajtuar më parë deklarata të ngjashme të pabazuara nga Petkoviç dhe zyrtarë të tjerë serbë për persekutimin e serbëve.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në baza të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjithë artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben si një ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore, dhe atë në formë kryesisht kuantitative, për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese njëmuajore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar - IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 30 nëntor 2024, në të cilën janë trajtuar 67 përmbajtje keqinformuese.

Përfundime

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes një mujore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit nëntor 2024, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Gjatë muajit nëntor 2024, analiza e 59 përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe ka zbuluar një përqindje të lartë të keqinformimit në kategori të ndryshme. Kategoria kryesore ka qenë "Lajm i rremë", që përbën 27% të rasteve, ndjekur nga "Dezinformatë" me 14% dhe "Clickbait" me 12%. Të tjera kategori si "Mashttrim" (10%), "Dezinformatë/Clickbait" (8%), dhe "Përmbajtje e paverifikuar" (8%) gjithashtu kanë pasur përfaqësim të rëndësishëm, ndërsa "Manipulim i fakteve" dhe "Gabim" përfaqësojnë nga 5%. Kombinimet e tjera të kategorive, si "Lajm i rremë/Mashttrim", kanë përqindje më të ulëta

Përmbajtjet keqinformuese janë përhapur kryesisht në disa fusha, me politiken që dominon me 37%, e ndjekur nga siguria me 25%. Kronika e zezë dhe temat Sociale kanë përfaqësuar secila 10% të përmbajtjeve të pasakta. Në muajin nëntor, ka pasur një dallim të dukshëm në përqindjet e publikuesve të këtyre përmbajtjeve, ku media sociale dominon me 81%, duke treguar se platformat si Facebook dhe TikTok janë vendet kryesore për shpërndarjen e dezinformatave dhe lajmeve të rreme. Media tradicionale ka një përqindje më të ulët, me 15%, duke pasqyruar përhapjen më të vogël të informacionit të pasaktë nëpërmjet kanaleve tradicionale të lajmeve.

Sipas analizës së 59 përmbajtjeve keqinformuese të identifikuara gjatë muajit tetor 2024, 21 prej tyre përmendin institucione të ndryshme. FSK dhe partitë politike (LVV, LDK, PDK, AAK) janë ndër institucionet më të përfolura, ndërsa kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka qenë figura më e përmendur në përmbajtjet keqinformuese në gjuhën shqipe, shpesh në kontekst krahasues me figura të tjera politike.

Nga analiza e 67 përmbajtjeve keqinformuese, 4 prej tyre (7%) janë publikuar në gjuhën serbe. Kryesisht, përmbajtjet keqinformuese janë shpërndarë në media, duke përfshirë disa raste në media sociale si Telegram. Ato përkasin kryesisht fushave të politikës dhe sigurisë, me një fokus të theksuar në politikë. Përmbajtjet përfshijnë manipulim të fakteve, dezinformata, teori konspirative dhe lajme të rreme. Në muajin nëntor 2024, u publikuan disa përmbajtje keqinformuese, përfshirë pretendime se muri i Kamala Harris ishte në Prishtinë, kur në fakt ishte në Atlanta, lidhje të pabaza mes ndërtimit të një nënstacioni policor në Zveçan dhe pushtimit të veriut, një lajm të rremë për pjesëmarrjen e Kosovës në Asamblenë e NATO-s, dhe një deklaratë të Sergei Lavrov që përsërite dezinformatën se masakrat në Bucha dhe Reçak ishin të inskenuara.

Gjatë muajit nëntor, hibrid.info ka analizuar dy deklaratat të paargumentuara. Gazetari Branislav Kërstiq ka pretenduar pa prova se bashkëshortja e kryeministrit Albin Kurti, Rita Augestad Knudsen, jeton dhe punon në Beograd, dhe mediat vendore e kanë transmetuar këtë pa e verifikuar. Po ashtu, Drejtori i Zyrës për Kosovën, Petar Petković, ka cilësuar shpërthimin në kanalin “Ibër-Lepenc” si një alibi për persekutimin e serbëve në veri, pa ofruar prova të mbështetura për këtë pretendim.

HIBRIDO.INFO